

Tuesday, May 11, 2021
10:16 AM

MEKANIZMAT E STANDARDIZUAR TË RAPORTIMIT PËR MONITORIMIN E ABUZIMEVE DHE KORRUPSIONIN NË SKEMËN E NDIHMËS EKONOMIKE

Kuptimi i termave

Korrupzioni¹. Korrupzioni përcaktohet si sjellje që mund të përfshijë mashtrim, vjedhje, keqpërdorim të pozitës apo autoritetit ose akte të tjera që janë të papranueshme që çojnë në keqorientimin e ndihmës ekonomike (NE) dhe që mund të shkaktojnë keqpërdorim të fondeve të NE, masë të vogël të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, përjashtimin nga përfitimi i kategorive të familjeve realisht në nevojë, ulje të perceptimit të komunitetit për punën e Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe politikat sociale shtetërore, si edhe humbje të besimit të komunitetit te SHSSH/MSHMS Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Korrupzioni mund të përfshijë elemente, të tilla si: shkelje të besimit dhe konfidencialitetit. Standardi mbi Kontrollin e Mashtrimit dhe Korruptionit përcakton korruptionin si veprimtari të pandershme në të cilën një drejtë, ekzekutiv, menaxher, specialist ose administrator shoqëror i një njësie vepron në kundërshtim me interesat e ligjit të NE-së dhe abuzon me pozitën e tij të besimit për të arritur ndonjë përfitim ose avantazhi personal për vete ose për një person ose subjekt tjetër.

Mashtrimi. Mashtrimi mund të shihet si një derivat i korruptionit dhe është një vepër e pandershme, e qëllimshme dhe e paramenduar që në veprim ose mosveprim, ka për qëllim për të përfituar nga pozita e besimit ose autoritetit. Mashtrimi përfshin akte të tilla si dhënien e deklaratave ose përfaqësimeve të rreme, manipulimi i informacionit, mashtrimi kriminal etj. Standardi mbi kontrollin e mashtrimit dhe korruptionit përcakton mashtrimin si veprimtari të pandershme që shkakton faktikisht ose potentialisht shpërdorime të mundshme financiare, humbje të mundshme financiare nga punonjësit ose familje përfituese të ndihmës ekonomike në të gjitha fazat e përfitimit të NE. Kjo përfshin, gjithashtu, falsifikimin e qëllimshëm, fshehjen, shkatërrimin ose përdorimin e dokumentacionit të falsifikuar, të përdorur ose të destinuar për përdorim, për qëllime të përfitimit të padrejtë të NE-së ose përdorimin jo të duhur të informacionit ose pozitës nga administratori (gjatë intervistimit të familjes aplikuese në zyrë ose gjatë vizitave në shtëpi).

Keqadministrimi skemës së NE-së. Keqadministrimi i skemës dhe fondeve të NE-së është veprim administrativ i paligjshëm, arbitrar, i padrejtë, diskriminues ose i ndërmarrë për qëllime të padrejta dhe që ndikon dukshëm dhe negativisht në interesat e familjeve në nevojë dhe fondet buxhetore të NE-së (keqadministrimi i fondit 6% duke u dhënë ndihmë ekonomike familjeve të cilat nuk kanë aplikuar për ndihmë ekonomike/shtesa e pagesës për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm pa dokument përvazhdimin e shkollës/mosfirmosja e formularit të aplikimit nga vetë qytetari por nga administratori/persona të tretë/deklarime të rreme të vendbanimit të qytetarit aplikues/përfitues i NE-së ... etj.).

Sjellje korruptive.² Sjellja korruptive përfshin kryerjen e një veprimi të pandershëm (jo të paanshëm), shkelje të besimit ose keqpërdorimin e informacionit për shkak të detyrës. Më tej, nëse vërtetohet, mund të jetë një vepër penale ose trajtohet si një shkelje disiplinore, duke ofruar shkaqe të arsyeshme për ndërprerjen e shërbimeve.

Hetimi. Hetimi është një kërkim apo bashkërendim i provave që lidhin ose tentojnë të lidhin një person me sjellje që cenon ligjin e NE-së.

Dhënia e informacioneve shpjeguese për interes publik. Dhënia e informacioneve shpjeguese për interes publik përfshin sjelljen e cila, sipas pikëpamjes së një raportuesi që vepron në mirëbesim, përfshin aktivitetin që është:

- I pandershëm;
- I korruptuar;
- Mashtrues;
- I paligjshëm;

¹ Sipas ligjit 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", "Korrupzion" është çdo veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, sipas legjisacionit penal në fuqi, në lidhje me çdo formë të korruptionit aktiv, korruptionit pasiv, shpërdorimit të detyrës ose kompetencave, ushtrimut të ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marjen e vendimeve, shpërdorimit të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimit të paligjshëm të interesave, si dhe çdo akt tjeter i njigashëm me to.

² Sipas ligjit 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", "Veprim ose praktikë e dyshuar korruptioni" është një veprim ose mosveprim, faktë ose shtethana të kryera nga organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korruption.

- në shkelje të ligjit ose akteve nënligjore;
- Joetik;
- I bën praktikat e punës të pasigurta;
- Sjellje që mund të shkaktojë humbje financiare ose humbje të besimit të publikut;
- Sjellje korruptive;
- Keqadministrim;
- Menaxhimi i pakujdeshëm ose i papërshtatshëm i resurseve që rezultojnë në humbje të konsiderueshme të fondeve publike;
- Rreziqe të konsiderueshme dhe specifike për përfitimin e NE-së në kundërshtim me ligjin.

Raportuesi³ (Sinjalizuesi). Raportuesi është një person që bën, përpiqet të bëjë ose dëshiron të bëjë një raport në lidhje me një shkelje të legjisacionit të NE, siç është përcaktuar më lart. Ai përfiton mbrojtje nga ndëshkimi nëse bën raportin. Raportuesi mund të preferojet të mbetet anonim ose jo.

Qëllimi

Të ofrojë një kuadër të përgjithshëm dhe fleksibël, për:

- Mbledhjen në kohë reale dhe të standardizuar, në mënyrë sistematike, të informacionit të saktë, objektiv dhe të besueshëm mbi shkeljet e kryera.
- Krijimin e bazave të qëndrueshme për marrjen e masave të nevojshme për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe menaxhimin e mashtrimit dhe korrasjonit, në zbatim të legjisacionit të NE.

Fusha veprimit (target-grupi):

- Drejtuesit e drejtive të SHSSH-së (Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të Ndihmës Ekonomike dhe Personave me Aftësi të Kufizuara DKP NE&PAK, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror DRSHSSH, Drejtoria e auditit të brendshëm, Drejtoria e burimeve njerëzore);
- Punonjësit e SHSSH-së, veçanërisht specialistët e kontrollit të NE-së;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale në rolin e politikëbërjes.

Ky dokument nuk synon të adresojë të gjitha situatat e mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të legjisacionit të përfitimit të NE, por ofron një kuadër mjaftueshëm fleksibël që mund të zbatohet edhe në shumicën e situatave të paparashikuara.

SHSSH merr përsipër dhe njeh që monitorimi dhe menaxhimi i mashtrimit dhe korrasjonit është pjesë integrale e qeverisjes së mirë.

SHSSH merr përsipër të zhvillojë dhe mbajë një kulturë të ndershmërisë dhe integritetit brenda institucionit dhe të krijojë procese që sigurojnë parandalimin, zbulimin dhe menaxhimin efektiv të mashtrimit dhe korrasjonit.

SHSSH angazhohet për një qasje me tolerancë zero ndaj mashtrimit dhe korrasjonit, në të gjithë veprimtarinë që ushtron dhe në të gjitha nivelet.

Sa më lart, parimet mbi të cilat SHSSH ndërton këtë politikë janë:

1. Një kulturë e shëndoshë etike
SHSSH-ja angazhohet maskimalisht për një kulturë të shëndoshë dhe të qëndrueshme etike, përmes ndërgjegjësimit dhe trajnimit të statit.
2. Angazhimi i lartë i drejtimit/menaxhimit
Drejtimi i lartë i SHSSH-së do të demonstrojë një nivel të lartë angazhimi për të kontrolluar rrezikun e mashtrimit dhe korrasjonit në NE.
3. Menaxhimi dhe ndërgjegjësimi i statit
Çdo punonjës dhe drejtues duhet të ketë një ndërgjegjësim të lartë mbi mashtrimin dhe korrasjonin, si dhe mbi përgjegjësitet që derivojnë nëse ky lloj aktiviteti zbulohet apo dyshohet.
4. Planifikimi dhe kontrolli i mashtrimit dhe korrasjonit
SHSSH-ja do të përdorë metoda kontrolli për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e mashtrimit dhe korrasjonit, të cilat janë objekt rishikimi, në kohë. SHSSH do të përdorë të dhënat në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (SMI) për evidentimin e rasteve potencialisht abuzuese /mashtruese gjatë fazës së planifikimit të kontrollit.
5. Forcimi i kontrollit dhe kontolleve të brendshme

³ Sipas ligjit 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", "Sinjalizues" është individi, i cili aplikon ose është në marrëdhënies pune ose ka punuar më paçë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrasioni.

SHSSH-ja do të realizojë kontolle efektive për zbatimin e legjisacionit të NE-së kundër rrezikut të mashtrimit dhe korruptionit (Metodologjia e kontrollit të NE; SMI-ja krijon mundësinë e pajisjes së specialistëve të kontrollit me llogari përdorimi dhe fjalëkalim).

6. Zbulimi i mashtrimit dhe korruptionit

SHSSH-ja do të zbatojë sisteme që synojnë identifikimin e mashtrimit dhe korruptionit në rast se mekanizmat e parandalimit dështojnë.

7. Mekanizmat e raportimit

SHSSH-ja siguron mjete adekuate për raportimin e sjelljes së paligishme/joetiike, kur është e dyshimtë ose e njohur dhe sigurohet që këto mjete janë tërësisht të njohura dhe të aksesueshme për stafin në çdo kohë, rrëthanë dhe situatë.

8. Mbrojtja e personave që bëjnë raporte për mashtrim dhe korruption

SHSSH-ja do t'u sigurojë mbrojtje aktive (ruajtjen e anonimitatit) atyre që raportojnë raste të dyshuara të mashtrimit dhe korruptionit dhe do të sigurojë që kjo politikë të njihet dhe zbatohet nga stafet e saj.

9. Trajtimi i rasteve të mashtrimit ose korruptionit të zbuluar ose të dyshuar

Objekt raportimi:

Procesi i aplikimit të NE-së pranë njësise administrative:

- Sjellja e administratorit;
- Sjellja e aplikuesve;
- Besueshmëria e deklarimit të tyre.

Procesi i vendimmarrjes së ndihmës ekonomike:

- Respektimi i afateve ligjore;
- Verifikimi në rrugë elektronike dhe në formë shkresore para vendimmarrjes;
- Besueshmëria e të dhënavë nga institucionet.

Procesi i përfitimit të NE-së:

- Zbatimi i ligjit për vizitat në shtëpi nga administratori;
- Përputhshmëria midis deklarimit dhe situatës reale të banimit;
- Deklarimet periodike;

- Respektimi i afatit kohor për tërheqjen e NE-së.

Procesi i kontrollit të NE-së nga DRSHSSH/DKP NE&PAK:

- Mospërdorimi i standardeve të dyfishta në trajtimin e çështjeve;
- Numri i kontrolleve të realizuara;
- Numri i shkeljeve;
- Rekomandimet e bëra dhe ndjekja e tyre.

Procesi trajtimit të ankesave

1. Monitorimi dhe vlerësimi i skemës së NE-së me fokus gabimet, abuzimet dhe mashtrimet

Sistemet e mbrojtjes shoqërore kërkojnë mekanizma monitorimi të institucionalizuar për të ndjekur performancën dhe për të mundësuar përshtatjen e kushteve të ndryshimit, nëse është e nevojshme. Nevoja për monitorim të rregullt të zbatimit dhe vlerësimit periodik, në veçanti përmes mbledhjes, përpilimit dhe analizës së të dhënavë të skemës së NE-së njihet nga standartet ndërkombëtare.

Skema e NE-së duhet të monitorohet rregullisht për sa u përket efektivitetit, eficiencës dhe arritjes së objektivave. Për këtë arsy, SHSSH si institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 9355/2005 të ndryshuar, i kërkohet të raportojë për zbatimin në baza vjetore të legjisacionit. Një nga aspektet më të rëndësishme të efektivitetit të ndihmës, është adresimi i familjeve të varfra, zbutja e varfërisë dhe ulja e rasteve korruptive (mashtimeve dhe abuzimeve me skemën e NE)

1.1 Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit

Procesi i zbatimit të legjisacionit do të jetë procesi i realizimit të objektivave, ndër të cilat edhe atyre që lidhen me identifikimin dhe uljen e rasteve korruptive (abuzimeve dhe mashtimeve me skemën e NE). Monitorimi dhe vlerësimi janë pjesë e të njëjtët proces, i cili mund të realizohet nga vete institucioni përgjegjës për zbatimin e legjisacionit, në këtë rast SHSSH-ja ose nga një organizatë tjeter e specializuar, si një proces që zhvillohet jashtë organizatës, por me përfshirjen e SHSSH-së që monitorohet dhe vlerësohet⁴. Të dyja mënyrat do të ndihmojnë në vlerësimin e zbatimit të legjisacionit, për të matur nivelin e realizimit të objektivave të tij në proces, për të vlerësuar nevojën për ndryshime dhe për të përcaktuar ndryshimet, veçanërisht në lidhje me uljen e rasteve abuzive.

⁴ Në rastin e SHSSH-së dhe skemës së NE-së, një vlerësues i jashtëm, mund të jetë një organizatë audituese (si KLSH) një individ (auditor i licencuar dhe i njohur nga MFE) ose një vlerësues i jashtëm me objektiva të përcaktuar qartë që udhëheqin procesin e vlerësimit.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të skemës së NE-së janë:

- Kapacitetet menaxhueze institucionale të NE-së në të tri nivelet (qendror, rajonal dhe lokal);
- Treguesit e monitorimit, si pjesë e të gjitha fazave (që nga faza e aplikimit të familjeve për NE-në deri në fazën e akordimit dhe tërheqjes së pagesës nga ana e familjeve);
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Mekanizma të zhđervjellët për raportimin e rasteve abuzive dhe korruptive;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

1.1.1 Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të NE, për realizimin e objektivave të përcaktuar nga politikat e mbrojtjes sociale, si pjesë e strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015–2020 dhe planit të saj të veprimit.

SHSSH-ja përmes drejtorisë rajonale është bartësi kryesor dhe përgjegjës për parandalimin dhe uljen e numrit të rasteve të abuzimit, mashtimit dhe korruptionit. Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE&PAK do të monitorojë treguesit, si dhe do të ndërmarrë veprime për vlerësimin e efektivitetit të skemës së NE-së. Në fund të çdo viti, duhet të përgatisë një raport profesional mbi “Gjetjet dhe Rekomandimet” e dala nga aktet e kontrollit, por edhe nga raportet e vlerësimit, raport i cili do t’i paraqitet përmirat drejtoret të përgjithshëm të SHSSH-së dhe më pas ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, në formën e rekomandimeve/propozimeve për ndryshime të politikave.

1.1.2 Treguesit e monitorimit, si pjesë të gjitha fazave (që nga faza e aplikimit të familjeve për NE-në deri në fazën e akordimit dhe tërheqjes së pagesës nga ana e familjeve)

Ky grup treguesish nuk është shterues por duhet të konsiderohet elementar për performancën e skemës së NE-së.

- % e fondit të abuzuar kundrejt fondit të shpenzuar për NE;
- Raporti i dëmeve të shkaktuara;
- Raporti i kërkesave të refuzuara;
- Raporti i rasteve që ri-futen në skemë;
- Shpejtësia e zgjidhjes së kërkesave;
- Raporti i ankesave;
- Raporti i mbajtjes së stafit;
- Kostoja/përfitimit - % e fondeve të shpenzuara për menaxhimin e skemës kundrejt fondeve të shpenzuara për familjet përfituese.

Disa nga treguesit e mësipërm nuk kanë lidhje drejtpërdrejt me abuzimin, por p.sh., në rastet kur për menaxhimin dhe operacionalizimin e skemës shpenzohet më shumë se për familjet e varfra, atëherë gjykohet që këtu ka një gabim. Në këtë rast është e vlefshme metoda e “vlerësimit të ndikimit”.

Cilësia e të dhënavës është faktori më i rëndësishëm që ndikon në cilësinë e vlerësimit të situatës ekonomike të familjeve aplikuese. Çdo formulë e përdorur sado e saktë të jetë nga pikëpamja ekonometrike nuk mund të kompensojë të dhënat e dobëta dhe të pa matura të variablate. Prandaj, është kritike që gjatë procesit të menaxhimit të skemës së NE-së të shqyrtohet disponueshmëria e të dhënavës dhe cilësia e tyre.

Numeri i të dhënavës të aksesueshme për publikun -transparencë- çdo llogaritje, procedurë, mbledhje të dhënavës dhe raport, duhet të ndjekë parimin e transparencës, me qellim që të sigurohet informacioni i vlefshëm dhe i saktë, përfshirë përmirësuar proceset dhe përfshirë besueshmërinë. Kjo do të thotë që jo vetëm të kesh më shumë të dhëna në dispozicion, por edhe t’i bësh të dhënat më të kapshtme dhe të kuptueshme për publikun.

1.1.3 Burimet e informacionit dhe instrumentet matës

Burime të informacionit kategorizohen në: i. burime të marra nga SMI; ii. ofruesit e shërbimeve (administratorë shoqërorë, verifikues, vendimmarrës); iii. familjet përfituese ose jo të ndihmës ekonomike; iv. media, shoqëria civile etj.

1.1.4 Mekanizma të zhđervjellët për raportimin e rasteve abuzive dhe korruptive

Raportimi përfshirë rastet abuzive dhe korruptive realizohet nëpërmjet konsolidimit të mekanizmave të raportimit nëpërmjet standardizimit, të: i. kontolleve; ii. procedurës së ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të bëra; iii. praktikës së denoncimit të rasteve abuzive.

1.1.5 Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të skemës së NE-së do të shpërndahen përfshirë informuar institucionet përgjegjëse për zbatimin e skemës (zyrat rajonale dhe bashkitë përkatëse), si dhe publikun,

për progresin e bërë në zbatimin e të drejtës së familjeve në nevojë për të përfituar mbështetje në para, nëpërmjet skemës së NE, por edhe të rasteve abuzive (si të familjeve ashtu edhe administratorëve) të identifikuara gjatë kontrollit dhe vlerësimit. Pas hartimit të raporteve, institucion kryesor përgjegjës për shpërndarjen e rezultateve është SHSSH, respektivisht DKPNE&PAK. Publikimi i rezultateve do të bëhet përmes faqes zyrtare të internetit të SHSSH-së, por edhe nëpërmjet organizimit të seminareve dhe tryezave të rumbullakëta, ku mund të shkëmbohen eksperiencia ndërmjet institucioneve pjesë përbërëse të sistemit por edhe jashtë tij, mbi parandalimin dhe uljen e rasteve të abuzimit.

2. Ngritura e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit

SHSSH-ja dhe institucionet relevante që janë përcaktuar nga ligji si pjesëmarrës në administrimin e skemës së NE, apo si ofrues të dhënash përfekt të zbatimit të ligjit, duhet të janë pjesë e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të skemës së NE. Ato duhet të ngrënë ose të ndihmojnë në ngritjen e mekanizmave të menaxhimit të ankesave në të gjitha nivelet e administrimit. Këta mekanizma duhet të funksionojnë si në rastet e kërkesave/ankesave/apelimeve të bëra nga qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë institucionit, ashtu edhe në rastet kur këto ankesa /kërkesa/apelime i drejtohen platformave si ajo e "bashkëqeverisjes" apo platformave të tjera të ngritura në ndihmë të qytetarëve.

2.1 Rastet potenciale të abuzimeve dhe mashtimeve me skemën e NE-së

2.1.1 Subjekti abuzues "Familja përfituese":

- Familjet raportojnë të dhëna të rreme ose fshehin të dhënat lidhur situatën e tyre ekonomike;
- Familjet e larguara përfekt deklarim të rremë riaplikojnë për ndihmë ekonomike brenda periudhës penalizuese;

- Familjet kompromisojnë administratorin shoqëror përfekt përfituar në mënyrë të padrejtë;
- Familjet përfekt qëllime përfitimi të ndihmës ekonomike bëjnë ndarje fiktive të anëtarëve të saj;
- Familjet deklarojnë vendbanime jo të vërteta.

2.1.2 Subjekti abuzues administratori shoqëror/zyrtari:

- Administratori nëpërmjet qëndrimit të tij i bën presion familjes, përfituar shpërbirim kundrejt pranimit të deklarimit;
- Administratori me dashje nuk bën kryqëzimin e të dhënavë të deklaruarë të familjeve me të dhënat e siguruara nga institucionet;
- Administratori me dashje, në momentin e aplikimit për ndihmë ekonomike, nuk verifikon ndarjet e qëllimshme;

- Administratori nuk bën verifikimin e gjendjes reale të kushteve të jetesës së familjes;
- Administratori nuk vepron në rastet e deklarimit të vendbanimit jo të vërtetë.

2.1.3 Subjekti abuzues DRSHSSH gjatë vendimarrjes:

- Mos respektimi i afateve kohore gjatë vendimarrjes;
- Vendimarrje pa përfunduar procesi i verifikimit në rrugë elektronike dhe manuale;
- Vendimarrje pa verifikuar riaplikimet e familjeve të refuzuara për 6 muaj nga NE;
- Vendimarrje përfituese (brenda 3-mujorit të parë të përfitimit) pa u realizuar vizita në shtëpi e tyre.

2.1.4 Subjekti abuzues Institucioni:

Mungesa të dhënash ose të dhëna jo të sakta të ofruara nga institucionet. Një tjetër mangësi është mungesa e të dhënavë të besueshme dhe të hapura ndaj publikut lidhur me punën e institucioneve qeveritare, veçanërisht në lidhje me luftën kundër korruptionit. Informacioni dhe statistikat ose nuk janë mbledhur, ose nuk janë në dispozicion përfituar për publikun, ose mblidhen në mënyrë aq rastësore sa nuk lejojnë monitorim dhe analizë. Një ndihmesë të madhe këtu jepen organizatat jo-qeveritare (shoqëria civile) të cilat kanë ndjeshmëri përfituese (respektimin e të drejtave të njeriut).

3. Sistemi i tregueseve të Monitorimit të Korruptionit dhe Mashtrimit me Legjislacionin e NE

Nga paragrafi i mësipërm, kuptojmë që rastet e korruptionit/abuzimit dhe mashtrimit me skemën e NE-së janë raste të bazuara, në i: eksperiencë; ii. Qëndrim; dhe iii. perceptim. Përfekt arsyet, gjatë procesit të identifikimit, evidentimit dhe raportimit të rasteve, duhen përdorur metodat dhe instrumentet relevante përfituese. Kështu, në rastet e korruptionit të bazuar në eksperiencë, metoda më e mirë përfituese është kontrolli dhe përgjigjja me efektivitet përfituese. Këtyre rasteve bazuar në masat e parashikuara nga ligji. Në rastin e korruptionit të bazuar në qëndrim, mënyra më e mirë përfituese është evidencat e rastit. Në rastin e korruptionit të bazuar në perceptim, mënyra më e mirë përfituese është metodat e kombinuar me metodën e kontrollit dhe verifikimit aty ku ka raste potenciale të abuzimit /mashtimit. Në rastin e tretë, atë të perceptimit, sondazhi dhe masat sensibilizuese dhe informuese përfituese brenda periudhës së zhvillimit.

3.1 Indikatorët e korruptionit dhe mashtrimit bazuar në eksperiencë.

Këta indikatorë realizohen/identifikohen dhe maten nëpërmjet akteve të kontrollit apo denoncimeve dhe verifikimeve të rasteve. Këta janë indikatorë sasiorë dhe mbi numrin e tyre gjykohet për ndryshime të mundshme në skemë dhe legjislacion⁵:

- Numri i rasteve të "Presionit për korruption" (identifikuar dhe evidentuar nga administratori apo denoncuesi, nëpërmjet mekanizmave të denoncimit të rasteve);

- Numri i rasteve të përfshirjes në korruption (identifikuar gjatë kontrollit apo denonuar dhe më pas vërtetuar nga verifikimet e bëra nga strukturat kompetente);

3.2 Indikatorët e korruptionit bazuar në qëndrim

Këta indikatorë maten nëpërmjet sondazheve gjatë vlerësimit të skemës së NE. Indikatorët në këtë rast janë indikatorë cilësorë dhe sasiorë:

- Njohja (identifikimi) i rasteve korruptive /mashtrimit;

- Pranimi i rasteve. Gjatë sondazhit, të intervistuarit tregojnë një farë tolerance ndaj akteve korruptive dhe abuzimit;

- Ndjeshmëria. Të intervistuarit nuk vlerësojnë që abuzimi me skemën e NE-së është një abuzim i vërtetë për shkak të "shumave të vogla" që mund të përfitohen padrejtësisht.

3.3 Perceptimet ndaj korruptionit

Këta indikatorë bazohen në perceptime të përgjithshme të të intervistuarve, të pavërtetuara dhe të paevidentuara. Matja e këtyre rasteve shërben në procesin e ndërgjegjësimit të familjeve, publikut dhe administratorëve /zyrtarëve, në lidhje me:

- Mundësia e presionit;

- Korruzioni i zyrtarëve;

- Politikë antikorruption.

1. Rasti bazohet në eksperiencën për të bërë korruption:

- Kur qytetarët i bëjnë pagesa informale administrator shoqëror kundrejt përsitimit të padrejtë të NE;

- Kur administratori ka këruar ryshfet kundrejt rregullimit të dokumenteve.

2. Qëndrimit ndaj korruptionit (qytetarëve dhe zyrtarëve):

- Identifikimi dhe matja nivelit të njohjes së qytetarëve mbi modelet e sjelljes korruptive;

- Toleranca ndaj sjelljeve korruptive e cila përcaktion vlerësimin e qytetarëve mbi pranueshmërinë e marries së dhuratave, parave, favoreve të ndryshme nga ana e administratorit shoqëror, në këmbim të aplikimit/trajtimit të familjeve në skemën e NE-së;

- Ndjeshmëria ndaj korruptionit e cila tregon tendencën e të anketuarve për të reaguar në situata hipotetike kur një familje përsiton padrejtësisht, dhe një zyrtar publik bën presion për të përsituar.

3. Aspektet e perceptimit ndaj korruptionit, zërthehen në tre indikatorë:

- Mundësia e presionit të korruptionit i cili mat pritshmëritë e qytetarëve për mundësinë për t'u përballur me presion të korruptionit, në bashkëveprim me zyrtarët publikë;

- Realizueshmëria e politikave kundër-korruptionit, është një indikator i cili vlerëson 'mendimet e qytetarëve' në lidhje me reagimet politikë dhe institucionale (masat politike qeveritare) ndaj korruptionit;

- Korruptimi i zyrtarëve publik tregon perceptimet e qytetarëve mbi nivelin e korruptimit të grupeve të ndryshme të zyrtarëve publik (jo domosdoshmërisht administratorët e NE-së).

4. Faktorë të tjerë që ndihmojnë në një sistem efektiv monitorimi të rasteve abuzive

Një nga çështjet kyçë që ka të bëjë me krijimin e strukturave të specializuara monitoruese kundër abuzimit dhe mashtrimit, është se si të kombinohen funksionet parandalues me ato ndëshkuese. Legjislacioni shqiptar është përpjekur që masa të parashikuara nga ligji nr. 9355/2005, i ndryshuar, t'i përfshijë të dyja, edhe pse funksioni parandalues zë pjesën më të vogël ndër këto masa. Shumica e detyrave të parashikuara në ligjin nr. 9355/2005, i ndryshuar, përfshin funksione të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Një mekanizëm efektiv i monitorimit të efektivitetit të skemës së NE, i realizuar nëpërmjet sondazheve vjetore, duhet të prezantohet në nivel kombëtar për të siguruar të dhëna dhe analiza të qëndrueshme, si dhe të integrojë vlerësimin e politikave sociale, veçanërisht atë të mbështetjes në para. Mekanizmi duhet të zbatohet përmes organizatave jashtë strukturave të SHSSH, nga ana e shoqërisë dhe rrjeteve civile. Ai duhet të shërbej si një mjet për hapjen e të dhënave administrative dhe rritjen e aksesit të publikut në informacion. Të dhënat që lejojnë gjurmimin e përdorimit të fondeve publike për reduktimin e varfërisë,

⁵ Indikatorët e korruptionit dhe mashtrimit identifikohen, përcaktohen dhe përkufizohen gjatë një procesi ku analizohen rastet korruptive. Ky proces realizohet me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve që marrin pjesë në administrimin e skemës.

(por edhe transfertat e tjera) duhet të bëhen publike si një informacion, duke lejuar kështu analizën e të dhënavëve dhe përdorimin e tyre për vlerësimin dhe ndryshimin e politikave.

Sistemi elektronik i NE-së mundëson që çdo kontrollues të ketë llogari përdoruese dhe fjalëkalim në rolin e përdoruesit “Kontrollues”. Një gjë e tillë: a) Lehtëson procesin e grumbullimit të informacionit dhe të dhënavëve gjatë fazës së planifikimit; b) Lehtëson procesin e përpunimit të tyre; c) Jep informacion për vlerësimin e riskut; d) Jep informacion mbi performancën e subjektit në zbatim të legjisacionit të NE-së që do të kontrollohet dhe e) Ul kostot e kontrollit pasi lejon që procesi të realizohet në vendin e punës së kontrolluesit dhe jo në terren.

ANEKSI 1
FORMAT RAPORTIMI I MASHTRIMIT

Lloji i mashtrimit (rrethoni kategorinë që i aplikohet me së shumti rastit konkret)	Shkaktari/përgjegjësia Familja përfituese e NE-së Administratori shoqëror DRSHSSH (drejtori, specialisti, specialist kontrollor) DKP NE&PAK (drejtori, specialist kontrollor) Tjetër (lutemi specifikoni)
A: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna	
B: Veprime të qëllimshme	
B1: Ndarjet e qëllimshme	
B2: Familje të refuzuara që rezultojnë përfituese	
B3: deklarim i tremë	
B4: Mosklikim i personit PAK gjatë aplikimit	
C: Familje të paverifikura	
D: Mospërputhje e dokumentacionit në dosje me të dhënrat e SMI-së	
E: Gabim teknik i aplikimit në SMI	
F: Tjetër (lutemi specifikoni)	
Kujt i raportohet? (emri)	
Adresa e personit të mësipërm	
Kontaktet e personit më sipër	
Kontakte të tjera	
Çfarë raportoni?	
(Cilat janë shqetësimet tuaja: - Jepni sa më shumë detaje që të jetë e mundur, si p.sh. përshkrimi i vendit, kohës, personit etj.)	
Ndonjë informacion shthesë?	
(Jepni sa më shumë detaje që të jetë e mundur si p.sh. përshkrimi i vendit, kohës, personit etj.)	
Kontaktet tuaja (Jo të detyrueshme)	
Adresa e-mail-it	
Telefoni	
Adresa postare	

ANEKSI 2
TABELA INDIKATORËVE

Indikatorët e abuzimit/mashtrimit/gabimeve bazuar në eksperience

Treguesit dhe të dhënrat për identifikimin e tyre	
Përkufizimi i treguesit - Treguesi 1.1	% e rasteve të dyshuara të abuzimit/mashtrimit/gabimeve në NE të denoncuara nga familjet aplikuese nëpërmjet linjës së dedikuar telefonike në raport me totalin e numrit të familjeve aplikuese
Treguesi 1.2	% e rasteve të dyshuara të abuzimit/mashtrimit/gabimeve në NE të pranuara nga individi që intervistohet gjatë vlerësimit të skemës së NE-së (në rastet kur kemi një vrojtim për securinë e skemës)

Treguesi 1.3	% e rasteve të denoncuara për abuzim/mashtrim/gabim, në raport me rastet e kontrolluara			
Treguesi 1.4	% e rasteve të gjetura të abuzimit/mashtrimit/gabimeve në NE, në raport me rastet e kontrolluara rutine.			
Si do të adresohen rastet	<p>1. Rastet e dyshimita të mashtrimit/abuzimit/gabimit do të identifikohen nëpërmjet kontrollit, kontrollimeve të të dhënave ose stafit (administratorëve shoqërorë dhe të tjera), siç përcaktohet në ligj.</p> <p>2. Rasti i dyshuar dhe raportuar do të konsiderohet i ndjekur kur të kemi një raport mbi rastin me konkluzionet dhe rekomandimet sipas legjisacionit në fuqi.</p>			
Kërkesat për raportimin	Kontrolluesi që ndjek rastin e denoncuar, do të gjenerojë raporte të kontrollit për rastet e denoncuara brenda një bashkie, duke specifikuar edhe rezultatet e kontrollit për rastet e dyshuara. Ky raport 3-mujor do të sigurojë informacionin e mëposhtëm: i. numrin e rasteve të dyshuara të mashtrimit/abuzimit/gabimeve të identikuara; ii. burimin e informacionit, iii. shpeshtësinë e ndodhjes së rastit; iv. mënyra e adresimit së bashku me masat e marra. Rastet e ndjekura do të ndahen sipas kategorive të mëposhtme: a) Në proces; b) Të myllura pa ndonjë veprim të mëtejshëm të kërkuar; c) Të myllura dhe të korriguara pa asnjë sankzion; dhe d) Të myllura dhe të korriguara me sankzione.			
Mjetet e verifikimit	<p>i) Raportet tremujore të inspektimit; ii. Raporti Vjetor i Progresit i SHSSH-së i publikuar në faqen e internetit të MSHMS-së; iii. Shënim në SMI (për të ruajtur gjurmueshmërinë mbi familjen); dhe iv. Masat e propozuara.</p> <p>ii) Raporti i vrojtimit.</p>			
Procedurat e raportimit	<table border="1"> <tr> <td>1. SHSSH-ja gjeneron raportet tremujore të kontrollit të SMI për NE</td> <td>2. SHSSH-ja përgatit një shënim të shkurtër dhe e hedh në SMI rastin. Në këtë rast duhet që në SMI të hidhen rekorde edhe përfamiljen aplikuese e cila nuk është kualifikuar përfunduar NE.</td> <td>3. Raporti i gjeneruar nga të dhënat e grumbulluara në terren nëpërmjet pyetësorëve.</td> </tr> </table>	1. SHSSH-ja gjeneron raportet tremujore të kontrollit të SMI për NE	2. SHSSH-ja përgatit një shënim të shkurtër dhe e hedh në SMI rastin. Në këtë rast duhet që në SMI të hidhen rekorde edhe përfamiljen aplikuese e cila nuk është kualifikuar përfunduar NE.	3. Raporti i gjeneruar nga të dhënat e grumbulluara në terren nëpërmjet pyetësorëve.
1. SHSSH-ja gjeneron raportet tremujore të kontrollit të SMI për NE	2. SHSSH-ja përgatit një shënim të shkurtër dhe e hedh në SMI rastin. Në këtë rast duhet që në SMI të hidhen rekorde edhe përfamiljen aplikuese e cila nuk është kualifikuar përfunduar NE.	3. Raporti i gjeneruar nga të dhënat e grumbulluara në terren nëpërmjet pyetësorëve.		
Formula e përllogaritjes	<p>[Numri i rasteve të dyshuara të abuzimit/mashtrimit/gabimeve, të vërtetuara gjatë vitit të mëparshëm në programin NE (kundrejt)/numri i rasteve të abuzimit/mashtrimit/gabimeve të raportuara/denoncuara gjatë vitit të mëparshëm në programin NE,]* 100</p> <p>[Numri i rasteve të dyshuara të abuzimit/mashtrimit/gabimeve, të vërtetuara gjatë vitit të mëparshëm në programin NE]</p>			

	(kundrejt) numrit të rasteve të abuzimit/mashtrimit/gabimeve të gjetura gjatë kontrollit rutinë gjatë vitit të mëparshëm në programin NE] * 100
Llogaritja në	Numër Përqindje
Frekuencia e matjes	Vjetore
Njësia përgjegjëse për raportimin e këtij Indikatori	Drejtoria e Kontrollit të Pagesave
Informacion mbi kontaktet dhe adresën e personit përgjegjës për kontrollin	
Emri i personit të ngarkuar për indikatorin	
Institucioni	SHSSH
Pozicioni	Drejtori i DKP NE&PAK
Adresa e-mail	

Indikatorët e abuzimit/mashtrimit/gabimeve bazuar në qëndrim

Treguesit dhe të dhënat për identifikimin e tyre

Përkufizimi i treguesit - Treguesi 2.1	
Treguesi 2.2	
Treguesi 2.3	
Treguesi 2.4	
Si do të adresohen rastet	
Kërkesat për raportimin	
Mjetet e verifikimit	
Procedurat e raportimit	
Formula e përllogaritjes	
Llogaritja në	
Frekuencia e matjes	Vjetore
Njësia përgjegjëse për raportimin e këtij indikatori	Drejtoria e Kontrollit të Pagesave
Informacion mbi kontaktet dhe adresën e personit përgjegjës për kontrollin	
Emri i personit të ngarkuar për indikatorin	
Institucioni	SHSSH

Pozicioni	Drejtor i DKP NE&PAK
Adresa e-mail	

Indikatorët e abuzimit/mashtrimit/gabimeve bazuar në perceptim “Efektiviteti i skemës së NE-së”

Treguesit dhe të dhënrat përmes identifikimin e tyre	
Përkuftimi i treguesit - Treguesi 2.1	Perceptimet e familjeve përfituese dhe atyre të refuzuara nga skema e NE-së mbi cilësinë e shërbimeve sociale, pavarësinë nga presionet politike, cilësinë e politikës, formulimin dhe zbatimin, dhe besueshmërinë e qeverisë, angazhim ndaj këtyre politikave.
Treguesi 2.2	
Treguesi 2.3	
Treguesi 2.4	
Si do të adresohen rastet	
Kërkesat përmes raportimin	
Mjetet e verifikimit	
Procedurat e raportimit	
Formula e përllogaritjes	
Llogaritja në	
Frekuencia e matjes	Vjetore
Njësia përgjegjëse përmes raportimin e këtij indikatori	Drejtoria e Kontrollit të Pagesave
Informacion mbi kontaktet dhe adresën e personit përgjegjës përmes kontrollin	
Emri i personit të ngarkuar përmes indikatorin	
Institucioni	SHSSH
Pozicioni	Drejtor i DKP NE&PAK
Adresë e-mail	

NR.PROT. 1928/1
DATË 6.5. 2021

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR
OPERATORIT TË SHËRBIMIT TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR
TË GJITHA BASHKIVE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI



